Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë, Kosovë E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504 604, Ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 18 qershor 2010

Numrat e lëndëve. 28/08, Zhivko ZHIVKOVIQ; 65/08, Bozhidar PEROVIQ; 68/08, Arsenije DIMITRIJEVIQ; 40/09, Dragisha ALLEKSIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 18 qershor 2010, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues,
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:

z. Rajesh TALWAR, Zyrtar ekzekutiv

Pasi morën parasysh ankesat e lartpërmendura, të parashtruara në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas diskutimeve, vendos si në vijim:

I. PROCEDUERAT PARA PANELIT

1. Ankesa e z. Zhivkoviqit (lënda nr. 28/08) është parashtruar më 18 korrik 2008 dhe është regjistruar në të njëjtën datë, ndërsa ankesat e tjera në fjalë (Peroviq, lënda nr. 65/08; Dimitrijeviq, lënda nr. 40/09 dhe Alleksiq, lënda nr. 40/09) janë parashtruar më 15 dhjetor 2008 dhe janë regjistruar në të njëjtën datë. Në procedurat para Panelit, zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq fillimisht

janë përfaqësuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (Danish Refugee Councill - DRC), mirëpo në dhjetor të vitit 2009, DRC-ja u tërhoq nga pjesëmarrja në procedurë para Panelit.

2. Më 21 tetor 2008, Paneli ia komunikoi ankesën e z. Zhivkoviqit Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), ndërsa më 19 janar 2009 ka kërkuar komentet e tij në emër të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës. PSSP-ja u përgjigj me komente përmes letrës së datës 11 mars 2009. Paneli ia komunikoi ankesat e z. Peroviqit më 26 maj 2009, të z. Dimitrijeviqit më 25 mars 2009 dhe të z. Alleksiqit më 28 maj 2009. PSSP-ja parashtroi komentet e UNMIK-ut për lëndën e z. Peroviqit më 15 qershor 2009, për lëndën e z. Dimitrijeviqit më 18 qershor 2009 dhe për lëndën e z. Alleksiqit më 17 qershor 2009.

3. Paneli morri informata të tjera nga z. Zhivkoviq më 29 maj 2009, nga z. Peroviq në prill 2009 dhe nga z. Alleksiq në shtator të vitit 2009.

II. FAKTET

4. Të gjithë katër ankuesit janë banor të Kosovës që aktualisht jetojnë si persona të zhvendosur në Serbi. Ata kanë qenë pronar të pronës së paluajtshme në Kosovë, ku kanë jetuar deri më 1999 kur, nga frika prej armiqësive, ata dolën nga Kosova. Më vonë ata morën vesh se prona e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

5. Të gjithë ankuesit kanë parashtruar padi në gjykatat kompetente kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të Kosovës, si dhe kundër komunave përkatëse, ku kërkonin kompensim për dëmtimin e shkaktuar ndaj pronës. Paditë e tyre janë regjistruar nga gjykatat në pjesën e dytë të vitit 2004.

6. Deri në fund të vitit 2008, gjykatat nuk kishin kontaktuar paditësit dhe nuk janë caktuar seanca dëgjimore.

7. Kërkesëpadia e ankuesit i përket grupit prej përafërsisht 17 000 kërkesëpadive për kompensim, të gjitha këto të parashtruara nga serbët etnikë, të cilët për shkak të armiqësive kishin lëshuar shtëpitë e veta në Kosovë në vitin 1999, dhe prona e të cilëve më vonë është dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të respektimit të afatit pesëvjeçar të parashkrimit të dorëzimit të padive civile për kompensim, këta ankues i parashtruan kërkesëpaditë e tyre para gjykatave të Kosovës përafërsisht në të njëjtën kohë gjatë vitit 2004. Kërkesëpaditë parashtroheshin kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve, si dhe në shumicën e rasteve, edhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (më tutje në tekst PKDNj), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, Mendimi i 24 marsit 2010, § 1; lidhur me bazën ligjore, mbi të cilën paditësit e bazuan kërkesëpadinë e tyre, shih Mendimin e njëjtë, § 5).

8. Lidhur me këto lëndë, më 26 gusht 2004, drejtori i Departamentit të Drejtësisë (DD) të UNMIK-ut u dërgoi letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe

të atyre të qarkut, si dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në letër, drejtori i DD-së theksoi se janë parashtruar mbi "14 000 kërkesëpadi" të tilla. Ai iu referua "problemeve që një numër kaq i madh i kërkesëpadive paraqet për gjykatat" dhe kërkoi që "për asnjë lëndë të tillë të mos caktohet seancë gjyqësore, deri kur bashkërisht të vendosim për mënyrën më të mirë të procedimit të këtyre lëndëve" (tekstin e plotë të letrës mund ta shihni, në Mendimin për lëndën *Millogoriq dhe të tjerët*, të cituar në § 7 më lartë, § 6).

9. Më 15 nëntor 2005, DD-ja i ftoi gjykatat që të fillojnë me procedimin e kërkesëpadive për dëme, të shkaktuara nga personat e identifikueshëm fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar që "pengesat për procedimin efikas të këtyre lëndëve" tani më nuk ekzistonin. Kërkesëpaditë e ndërlidhura me luftën e vitit 1999 nuk janë trajtuar përmes kësaj letre.

10. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së i këshilloi gjykatat se lëndët që nuk janë caktuar në bazë të kërkesës së 26 gushtit 2004, tani duhet të procedohen.

11. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut për gjyqësorin e Kosovës përfundoi dhe Misioni për Sundim të Ligjit i Bashkimit Evropian (EULEX) morri kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), përmes së cilës mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

12. Rrethanat e lëndëve veç e veç për këtë çështje janë të përshkruara në shtojcën e këtij vendimi.

III. ANKESAT

13. Në thelb, ankuesit pohojnë se gjykatat përkatëse kanë pezulluar procedurat lidhur me paditë për dëmet ndaj pronës dhe si rrjedhojë këto procedura nuk kanë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, gjë që paraqet shkelje të nenit 6 § 1të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj). Ata pohojnë se për të njëjtën arsye, e drejta e tyre në mjet të efektshëm juridik për zgjidhjen e kontestit sipas nenit 13 të KEDNj-së gjithashtu është shkelur.

14. Po kështu, ankuesit ankohen për shkeljen e të drejtës së tyre në pronë, e cila është garantuar përmes nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNj-së. z. Zhivkoviq në përgjithësi ankohet për faktin se prona e tij është dëmtuar ose shkatërruar. Zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq ankohen për refuzimin e gjykatave kompetente që të vendosin për paditë e tyre lidhur me dëmet.

15. Zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq and Alleksiq gjithashtu pohojnë se është bërë shkelja e të drejtës së tyre për jetë familjare dhe shtëpi (neni 8 i KEDNJ-së), pasi ata janë të penguar të kthehen në shtëpitë e tyre.

IV. BASHKIMI I ANKESAVE

16. Paneli vendosi që në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së tij të punës, t'i bashkojë katër ankesat.

V. LIGJI

17. Para se të merret parasysh lënda lidhur me bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të pranohet e njëjta, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të paraqitura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006.

18. Duke konsideruar historikun e përbashkët faktik dhe ligjor të lëndëve të ankuesve, Paneli mendon se është e duhur që të bashkohen komentet e ndryshme të PSSP-së për katër lëndët në fjalë dhe të merr parasysh se argumentet e ndryshme të ngritura lidhur me secilën lëndë veç e veç janë paraqitur përkitazi me të katër lëndët e bashkuara.

19. PSSP-ja konsideron se ankesat e parashtruara nga katër ankuesit janë të papranueshme për shkak të mosshterrjes së mjeteve juridike. Ai deklaron se më 15 nëntor 2005, DD-ja ka ftuar gjykatat që të fillojnë me procedimin e padive për dëmet e shkaktuara nga personat e identifikueshëm fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar se nuk ekzistonte më pengesa për procedimin efikas të këtyre lëndëve. Më 28 shtator 2008, pas konsultimeve me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili u pajtua të ofrojë mbështetje logjistike për procedimin e padive të mbetura, DD-ja mendoi se lëndët e mbetura duhet të procedohen dhe gjykatat janë informuar në mënyrë të duhur për këtë. Gjithashtu, PSSP-ja thekson se lëndët e lartpërmendura janë riaktivizuar rishtazi.

20. Në bazë të kësaj, duke marrë parasysh se procedurat ligjore lidhur me paditë për dëmet janë duke pritur vendimet nga gjykatat relevante, dhe se tani do të procedohen, PSSP-ja deklaron se ankesat në fjalë janë të papranueshme *prima facie* për shkak të mosshterrjes së mjeteve juridike.

21. Paneli thekson se qëllimi i kushtit për shterjen e mjeteve juridike në dispozicion ka të bëjë me dhënien e mundësisë UNMIK-ut për parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve që pohohet se i ka bërë, para se këto pohime t'i dorëzohen Panelit. Sipas nenit 3.1 të Rregullores nr. 2006/12 ankuesi duhet të ketë qasje normale në mjetet juridike në dispozicion dhe që janë të mjaftueshme për marrjen e vendimit lidhur me shkeljet e pohuara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjafteshmërisht i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, mosekzistimi i të cilave do të rezultojë me mungesë të pranueshmërisë dhe efektshmërisë së kërkuar (Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut (PKDNj) *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, vendimi i datës 31 mars 2010, § 45, dhe *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, vendimi i datës 31 mars 2010, § 35; krahaso lidhur me kushtin për shterjen e mjeteve juridike vendore sipas nenit 35 § 1 të KEDNj-së, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma kryesore), *Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 46113/99 *etj.*, vendimi i datës 1 mars 2010, § 70, duke cituar nga

GjEDNj, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 16 shtator 1996 1996, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1996-IV, f. 1210, § 66).

22. Paneli konsideron se vërejtja e bazuar në mosshterrjen e mjeteve juridike nuk mund të shqyrtohet në mënyrë të përgjithshme, por duhet të shqyrtohet në kontekstin specifik për secilën prej ankesave. Në këtë kontekst Paneli gjithashtu do të konsideron nëse ankesat e caktuara ngritin vërejtje të tjera lidhur me pranueshmërinë e tyre (shih, në të njëjtin kuptim, PKDNj, *Millogoriq*, nr. 38/08, vendimi i datës 22 maj 2009, § 15).

Shkelja e pohuar e neneve 6 § 1 dhe 13 e KEDNj-së

23. Paneli konsideron se për aq sa ankuesit thirren në shkeljen e neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së, ata në fakt paraqesin dy ankesa (shih qasjen e zbatuar në PKDNj, *Millogoriq*, të cekur në 22 më lartë; krahaso GJEDNj, *Aqimoviq kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendimi i datës 30 maj 2000; GJEDNj, *Kutiq kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendimi i datës 11 korrik 2000). Në njërën anë ata ankohen për faktin se për shkak të pezullimit të procedurave në gjykatat kompetente, ata nuk kanë qenë në gjendje të marrin vendimin për paditë e tyre lidhur me dëmtimet e pronave. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngritë çështjen të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNj-së dhe të së drejtës së tyre për mjet të efektshëm juridik sipas nenit 13 të KEDNj-së. Ndërsa, në anën tjetër, ata ankohen për kohëzgjatjen e procedurës para gjykatave kompetente, për shkak të faktit se procedurat kanë filluar në vitin 2004 dhe se paditë e tyre nuk janë shqyrtuar që atëherë. Kjo ankesë mund të ngritë çështjen e të drejtës së tyre për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNj-së.

24. Paneli vëren se në komentet e tij, PSSP-ja nuk ka treguar ndonjë mjet specifik juridik në dispozicion për ankuesit lidhur me pezullimin apo kohëzgjatjen e procedurave. Në këtë drejtim, as Paneli nuk sheh ndonjë mjet të tillë juridik. Fakti se më 28 shtator 2008 gjykatat janë udhëzuar që të vazhdojnë me shqyrtimin e padive, siç janë ato të ankuesve nuk është relevant nga pikëpamja e mjeteve juridike që duhet të shfrytëzohen nga ankuesit. Rrjedhimisht, Paneli përfundon se ankesa e parashtruara sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së nuk mund të refuzohen për arsye të mosshterjes së mjeteve juridike brenda domethënies së nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih PKDNj, *Millogoriq*, të cituar në § 22 më lartë, § 17).

25. Paneli më tej përkujton vendimin e tij për lëndën *Millogoriq* se ankesat e parashtruara sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së ngritin çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Paneli rrjedhimisht vjen në përfundim se këto ankesa nuk janë të pabazuara në shikim të parë brenda domethënies së nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (PKDNj, *Millogoriq*, cituar në § 22 më lartë, § 18).

26. Nuk është gjetur ndonjë bazë tjetër për shpalljen e këtyre ankesave si të papranueshme.

Shkelja e pohuar se nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

27. Të gjithë ankuesit ankohen për shkeljen e së drejtës së tyre në pronë (neni 1 i Protokollit nr.1). z. Zhivkoviq në përgjithësi ankohet për faktin se prona e tij është dëmtuar apo shkatërruar. Zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq ankohen për refuzimin e gjykatave kompetente për të vendosur mbi paditë e tyre për dëme.

28. Paneli përkujton se në bazë të nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ka juridiksion vetëm për "ankesat që ndërlidhen me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se më 23 prill 2005 apo që kanë dalë nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date, në rastet kur këto fakte kanë për rrjedhojë shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Dëmtimi apo shkatërrimi i pronës janë akte të atypëratyshme, të cilat nuk rezultojnë me shkelje të vazhdueshme (shih PKDNj, *Llajoviq*, nr. 09/08, vendimi i datës 16 korrik 2008, § 7). Rrjedhimisht, kjo pjesë e ankesës së parashtruar nga z. Zhivkoviq nuk hynë në kuadër të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

29. Lidhur me ankesat e parashtruara nga zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq, është e vërtetë se këta ankues nuk ankohen drejtpërsëdrejti për dëmtimin dhe shkatërrimin e pronave të tyre, por për faktin se për shkak të pezullimit të procedurave që ata i filluan, deri më tani nuk kanë mundur të marrin kompensimin për dëmin. Sidoqoftë, për aq sa procedurat gjyqësore ceken nga pikëpamja e së drejtës në pronë, këto procedura nuk mund të ndahen nga aktet, në të cilat bazohen paditë para gjykatave. Apo, për të deklaruar në aspektin pozitiv, siç ka bërë Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me juridiksionin e saj sipas KEDNj-së:

> "… Juridiksioni kohor i Gjykatës duhet të përcaktohen në lidhje me faktet që përbëjnë ndërhyrjen e pohuar. Mosshfrytëzimi pasues i mjeteve juridike të parapara për trajtimin e ndërhyrjes nuk mund ta sjellin atë para juridiksionit kohor të gjykatës" (GjEDNj (Dhoma kryesore), *Blleçiç kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, aktgjykimi i datës 8 mars 2006, § 77, *KEDNj*, 2006-III).

30. Rrjedhimisht del se kjo pjesë e ankesave të zotërinjve Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq gjithashtu nuk hyn në kuadër të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit (shih PKDNj, *Gojkoviq*, cituar më lartë, §§ 24-25).

Shkelja e pohuar e nenit 8 të KEDNj-së

31. Zotërinjtë Peroviq, Dimitrijeviq dhe Alleksiq ankohen për shkeljen e të drejtës së tyre për jetë familjare dhe për shtëpi (neni 8 i KEDNj-së).

32. Siç u cek më lartë, prona e ankuesve, duke përfshirë shtëpinë në Kosovë, ku ata jetonin me familjen e tyre, është shkatërruar diku në pjesën e dytë të vitit 1999. Për arsyen e lartpërmendur, çfarëdo ankese lidhur me shkatërrimin e shtëpisë së ankuesit rrjedhimisht mbetet jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit (shih §§ 29-30).

33. Përveç kësaj, për këtë pjesë të ankesës nuk është dhënë arsyetimi.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

- SHPALL SI TË PRANUESHME ANKESAT LIDHUR ME TË DREJTËN NË QASJE NË GJYKATË DHE TË DREJTËN NË MJET TË EFEKTSHËM JURIDIK (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT) DHE LIDHUR ME TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR BRENDA KOHËS SË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT)

- SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN E MBETUR TË ANKESAVE.

Rajesh TALWAR
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues

Shtojcë

Lënda nr. 28/08, Zhivko Zhivkoviq

1. Ankuesi është banor i Kosovës që tani për tani jeton si person i zhvendosur në Serbi.

2. Ai është pronar i shtëpisë që gjendet në Prishtinë, ku ka jetuar deri në gusht të vitit 1999. Ankuesi është informuar nga fqinjët se prona e tij është shkretuar dhe shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

3. Në qershor të vitit 2004, ankuesi parashtroi padi për kompensim para Gjykatës së qarkut të Prishtinës kundër Komunës së Prishtinës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkonte kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 36 000 euro në emër të kompensimit për këtë dëm.

4. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata e qarkut nuk kishte kontaktuar paditësin dhe nuk është caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 65/08, Bozhidar Peroviq

5. Ankuesi është banor i Kosovës që tani për tani jeton si person i zhvendosur në Serbi.

6. Ankuesi është pronar i shtëpisë në komunën e Deçanit, ku ka jetuar deri në qershor të vitit 1999. Fqinjët e kanë informuar se prona e tij është shkretuar dhe shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

7. Më 2 korrik 2004, ankuesi ka ngritur padi për kompensim në Gjykatën komunale të Deçanit kundër Komunës së Deçanit, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkon kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon shumën prej 68 000 eurove në emër të kompensimit për këtë dëm.

8. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 68/08, Arsenije Dimitrijeviq

9. Ankuesi është banor i Kosovës që tani për tani jeton si person i zhvendosur në Serbi.

10. Ai është pronar i dy shtëpive që gjenden në Prizren, ku ka jetuar deri në gusht të vitit 1999. Fqinjët e tij e kanë informuar se njëra prej shtëpive të tij është shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

11. Më 9 qershor 2004, ankuesi ka parashtruar padi për kompensim në Gjykatën komunale të Prizrenit kundër Komunës së Prizrenit, IPVQ-ve UNMIK-ut dhe

KFOR-it, përmes së cilës kërkonte kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 604 000 euro në emër të kompensimit për këtë dëm.

12. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 40/09, Dragisha Alleksiq

13. Ankuesi është banor i Kosovës që tani për tani jeton si person i zhvendosur në Serbi.

14. Babai i ndjerë i ankuesit ishte pronar i një shtëpie në komunën e Podujevës, ku ai dhe familja e tij kanë jetuar deri në qershor të vitit 1999. Fqinjët e tyre i kanë informuar se shtëpia është shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

15. Më 6 korrik 2004, ankuesi në cilësinë e trashëgimtarit të babait të tij të ndjerë ka ngritur padi në Gjykatën komunale të Podujevës kundër Komunës së Podujevës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkon kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 103 500 euro në emër të kompensimit për këtë dëm.

16. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.